

**STATUT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SARANDA MARINA INVEST” Sh.p.k**

Bazuar ne legjislacionin e cituar me poshte:

- Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” me poshte referohet si “Ligi Per Shoqerite”,
- Nr. 7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit”;
- Nr. 9723 , date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”;

Veprimtaria e shoqerise, **“SARANDA MARINA INVEST” shpk**, do te organizohet dhe do te drejtohet sipas ketij Statuti, te trajtuar ne te njejtien dokument me Aktin e Themelimit.

**PJESA E PARE
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1
Ortaket**

1. Ortaku i shoqerise eshte:

Shoqeria “ARMAAR GROUP” shpk me seli ne adresen Rr: "Muhedin Llagami", Pallati Vala, K. 1, Nr. 7, Tirane, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Nr. NIPT: M01517007J, perfaqesuar nga administratori **Zj. Xhensila Pupa**, e bija e Robert-it, e datëlindjes 12.10.1995, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, lindur ne Pogradec dhe banuese në Tirane, e pajisur me letërnjoftim (ID) me Nr. J56012062G dhe me ortak te vetem **Z. Armand Lilo**, i biri i Nazmi-ut, i datelindjes 11.01.1978, madhor dhe me zotesi te plete per te vepruar, lindur ne Pogradec dhe banues ne Tirane, i pajisur me letërnjoftim (ID) me Nr. H80111177D.

**Neni 2
Emri**

1. Emri i shoqërisë është: **“SARANDA MARINA INVEST” shpk**, (më poshtë referuar si “Shoqëria”).

**Neni 3
Selia e Shoqerise**

1. Selia e Shoqerise eshte ne adresen: **Rr: "Muhedin Llagami", Pallati Vala, K. 1, Nr. 7, Tirane**.
2. Shoqëria mund te hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës se Shqipërisë ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**Neni 4
Forma ligjore**

1. Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si **Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar**.

**Neni 5
Kohëzgjatja**

1. Shoqëria do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar per një periudhe te pacaktuar (pakufizuar).

**Neni 6
Objekti i aktivitetit**

1. Objekti i veprimtarise se shoqerise **“SARANDA MARINA INVEST” shpk**, konsiston ne:
“Zbatim, projektim te ndertimeve civile, ekonomike, punime dhei, sistemim taracime, prodhime elementesh te parafabrikuara, betoni e beton arme, ndertime civile e turistike, rrugesh, vepra arti, hekurudha e kanalizime, punime karperterie, investime ne sektorin e energetikës. Palester.



Aktivitete ne sektorin e turizmit. Eksport-import dhe tregtim me shumice e pakcie te te gjitha llojeve te materialeve dhe pajisjeve te ndertimit. Projektme Masterplane, Projektim - zbatim konstruktiv. Projektim - zbatim te objekteve te ndryshme me konstruksione metalike.

Aplikimi pranë institucioneve/organeve shtetërore me qëllim marrjen e lejeve/autorizimeve/licensave/miratimeve dhe çdo akti tjetër të nevojshëm per ndërtimin apo marrjen në përdorim të infrastrukturave portuale.

Ndërtimin dhe/ apo administrimin e Porteve të Jahteve, të infrastrukturës mbështetëse turistike të tyre, Hoteleve, Vilave, Apartamente, Restoranteve, Qendra Sportive dhe SPA, pishina dhe çdo aktivitet ose shërbim tjetër turistik në përputhje me projektin arkitektonik dhe inxhinierik që do të ideohet dhe projektohet për këtë qëllim.

Realizimin e veprimtarive te lejuara ne Portet Turistike, duke perfshire por mos u limituar në:

- a) *Administrimin e qëndrimit të përkohshëm të mjeteve lundruese turistike.*
- b) *Dhënien me qira apo forma të tjera përdorimi të parkimit të mjeteve lundruese turistike në vendet e caktuara, brenda hapësirës ujore dhe tokësore të portit.*
- c) *Mirëmbajtja e mjeteve lundruese turistike.*
- d) *Shërbimi i akomodimit dhe i shërbimeve të tjera në funksion të turizmit.*
- e) *Veprimtari të tjera turistike, të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore.*

Ofrimi i shërbimit të furnizimit të anijeve turistike dhe tregtare me karburant, brenda infrastrukturës portuale të Portit, ne perputhje me e lejeve/autorizimeve/licensave/miratimeve dhe çdo akti tjetër të nevojshëm.

Ofrimi i shërbimit të furnizimit të anijeve turistike dhe tregtare, dhe subjekteve tregtare qe operojne brenda territorit te portit, me energji elektrike ne perputhje me e lejeve/autorizimeve/licensave/miratimeve dhe çdo akti tjetër të nevojshëm.

Aplikimi dhe marrja me koncesion apo në forma të tjera përdorimi nëpermjet një kontrate me shtetin, të infrastrukturave portuale dhe zonës përreth tyre.

Për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të kryejë gjithashtu, si aktivitet ndihmës dhe jo parësor, të gjitha veprimet mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, industriale, financiare dhe tregtare, në Shqipëri si dhe jashtë saj, në masën që vlerësohet e dobishme dhe/ose e përshtatshme nga organi administrativ dhe mundet gjithashtu të marrë përsipër, gjithmonë për qëllime ndihmëse, pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive ose ndërmarrjeve dhe ose entiteteve të tjera me objekt të ngashëm, të afërt ose të lidhur me të vetin, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligjet në fuqi.

Të gjitha veprimtaritë e pëershkruara më sipër mund të zhvillohen si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose blejë/përfitojë direkt ose indirekt pjesëmarrje, në shoqëri, ndërmarrje, agjenci apo sipërmarrje të tjera, të cilat kanë fushë veprimtarie të ngashme.

Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie apo transaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprime tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të cfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arrijen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.


2. Shoqeria mund te kryeje edhe aktivitete te tjera shtese, me qellim permbyshjen e veprimtarise te saj kryesore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

PJESA II **KAPITALI I SHOQËRISE DHE KUOTAT**

Neni 7

Kapitali i Shoqërisë

1. Kapitali i shoqerise eshte 1'055'000'000 (Nje miliard e pesedhjete e pese milion lek) ALL, i marre persiper dhe i nenshkruar nga ortaku.
2. Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 (nje) kuote, e cila zoterohet nga ortaku si me poshte:



Ortaket	Kuotat e Nenshkruara	Vlera ne Leke	Perqindja (%)
SHOQERIA “ARMAAR GROUP” SHPK	1	1'055'000'000	100%
Total	1	1'055'000'000	100%

3. Kapitali themeltar eshte vetem ne monedhen vendase, lek.

III. STRUKTURA DREJTUESE TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 8

Përgjegjësia e kufizuar

1. Ortaket jane përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.

Neni 9

Të drejtat e lidhura me cdo kuotë

1. Cdo kuote e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korresponduese në mbledhjet e ortakëve dhe do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

Neni 10

Fitimi dhe kalimi i kuotave

1. Kuotat e kapitalit te shoqerise fitohen apo kalohen nepermjet:
 - a. kontributin ne kapitalin e shoqerise;
 - b. shitblerjes;
 - c. trashegimise;
 - d. dhurimit;
 - e. cdo menyre tjeter parashikuar me ligj.
2. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata do behet me shkrim.

Neni 11

Detyrimet e Ortakëve

1. Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse ftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj, si dhe të përbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.

PJESA IV ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Neni 12

Të drejtat e asamblesë së pergjithshme

1. Asambleja e pergjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha cështjet e veprimtarisë së saj.
2. Asambleja e pergjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët.
3. Vetëm asambleja e pergjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
 - (a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
 - (b) pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
 - (c) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencioni të dhënë nga ortakët;

- (d) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;
- (e) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
- (f) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit;
- (g) pjesetimin dhe anullimin e kuotave;
- (h) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- (i) miratimin e raporteve vjetore dhe bilancit të shoqërise si dhe shpërndarjen e fitimit;
- (j) blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;
- (k) marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e cdo të drejtë për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
- (l) të vendosë për investimet;
- (m) të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie
- (n) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
- (o) të caktojë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
- (p) të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose cdo pagese mbi largimin e drejtoreve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
- (q) të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
- (r) emerimin dhe shkarkimin e likujduesve, ekspertëve kontabël te autorizuar;
- (s) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- (t) percaktimin e shperblimeve per likujduesit, ekspertet kontabel;
- (u) mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret;
- (v) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin dhe mbledhjes se asamblese;
- (w) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
- (x) përcaktimin e buxhetit vjetor;
- (y) miratimin e cdo cështje tjeter zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së përgjithshme në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.
- (z) Marrjen e huave ne emer te shoqerise dhe vendosjen e kushteve te huase
- (aa) Lidhjen e marreveshjeve per dhenien e huave

4. Asambleja e përgjithshme do të ketë të drejtë të vendosë mbi cdo cështje që tejkalon aktivitetin e përditshëm të shoqërisë.

Neni 13

Vendimet e asamblesë së përgjithshme

1. Vendimet e renditura përsa i përket ndryshimit të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë merren me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Neni 14

Thirrja e asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme do të thirret nga administratorët të paktën njëherë në vit në selinë e Shoqërisë ose ne cdo vend tjeter nëse percaktohet ne njoftim.
2. Gjithashtu, ortakët të cilet perfaqësojnë të paktën 20 për qind të totalit të votave ne asamblenë e përgjithshme të shoqërisë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur asamblenë e përgjithshme. Në kërkesën drejtar administratorëve mund të përfshihen dhe cështjet e posacme të rendit të ditës.
3. Asambleja e përgjithshme do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratorët, njoftim, i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande, email, telexi apo faksi, jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpëra datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi i shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë. Gjithashtu, asambleja e përgjithshme mund të thirret nëpërmjet postës elektronike me të njëjtat kushte dhe afate.
4. Njoftimi për takimin e asamblesë së përgjithshme do të tregojë datën kohën dhe vendin e takimit si dhe cështjet e rendit të ditës.

- Nëse data për mbledhjen e ardhshme të asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qënë prezantë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.
- Nëse të gjithë ortakët janë prezantë në asamblenë e ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përbushjes së kërkave formale të caktuara më sipër nëse të gjithë ortakët janë dakord.

Neni 15

Vendimet e marra në asamblenë e pergjithshme

- Vendimet në asamblenë e pergjithshme të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 % të kuotave. Vendimet në asamblesë e përgjithshme të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar mund të merrën vetëm nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zoterojnë më shumë së gjysmën e numrit total të votave.
- Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- Cdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e asamblese, të cilat do të janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- Nëse mbledhja e asamblese se pergjithshme thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 14 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëtin rend dite.

Neni 16

Drejtimi i mbledhjes se asamblese se pergjithshme

- Kryetari i mbledhjes së asamblese se pergjithshme do të caktohet nga ortaket.
- Do të aprovojen apo refuzohen vetëm ato cështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e asamblese. Diskutimet mbi cështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japid pëlgimin e tyre.

Neni 17

Procesverbal i mbledhjes së asamblese se pergjithshme

- Për cdo mbledhje të asamblese se pergjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Prosesverbal duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregtar dhe një për se cilin ortak. Prosesverbalit i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- Prosesverbalit do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit.
- Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, një kopje e procesverbalit do të publikohet jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes në këtë faqe.
- Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesvebalit dhe shpërndarjen e tij.

PJESA V ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 18

Administrimi i Shoqërisë

- Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një ose me shume administratore, te cilet do te përfaqësojnë Shoqërinë. Gjithashtu, asambleja e pergjithshme mund të caktojë kompetenca përfaqësimi individuale se cilët prej administratorëve.
- Administratorët mund të autorizojnë palë të treta që t'i përfaqësojnë ata në transaksione të vecanta.



3. Administratorët do të organizojnë dhe menaxhojnë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ata janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në të gjitha cështjet që kanë lidhje me të.
4. Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
5. Administratorët kanë të drejtat e mëposhtme:
 - (a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
 - (b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
 - (c) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
 - (d) nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
 - (e) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrien e paradhënieve;
 - (f) dhënien e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënieve të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;
 - (g) punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
 - (h) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i térheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të myllin marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të térheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërprenjnë procedimet;
 - (i) administratorët kanë të drejtë marrin cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
 - (j) mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
 - (k) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
 - (l) administratorët janë përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dicka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
 - (m) thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
 - (n) publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
 - (o) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
 - (p) marrin vendime mbi të gjitha cështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëni e saj të jashtme.
6. Personi i mëposhtëm do të caktohet administrator për një periudhë 5 (pesë) vjecare me të drejtë ripërtëritjeje:
Zj. Emirjana Vata, e datëlindjes 11.01.1986, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, lindur në Likmetaj, Durrës dhe banuese në Durrës, e pajisur me letërnjoftim (ID) me Nr. I65111045M.

PJESA VI
VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET
Neni 19

Viti finanziar, pasqyrat vjetore financiare

1. Viti finanziar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë finanziar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.
2. Në fund të cdo viti finanziar, administratorët do të përbushin detyrat e mëposhtme:
 - a. përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
 - b. përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;



c. përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.

3. Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm për miratim.

Neni 20
Fitimi i Shoqërie

1. Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri.
2. Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga asambleja e ortakëve dhe do të dorëzohet në organet tatumore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

PJESA VII
PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 21
Prishja dhe likuidimi

1. Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
 - a. vendim i mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
 - b. bashkimi me një shoqëri tjeter;
 - c. vendimi i gjykatës me juridikcion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
 - d. në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
2. Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

PJESA VIII
TE PERGJITHSHME

Neni 22
Te pergjithshme

1. Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpilen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridikcion përkatës.
2. Ligji zbatues është ligji shqiptar
3. Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (kater) kopje origjinale.

Tirane, me 19.10.2023

ORTAKU THEMELUES:
SHOQERIA "ARMAAR GROUP" SHPK
ADMINISTRATORE:
Zj. Xhensila PUPA

